

NJIHUNI ME TË DREJTAT TUAJA



Ju keni të drejta ndërkohe që
punoni në Shtetet e Bashkuara

1-888-373-7888 Linjë kombëtare kundër Trafikimit të
Qënieve Njerëzore (**brenda Shteteve të Bashkuara**)

DËRGONI MESAZH ME TEKSTIN "HELP" NË NUMRIN 233733
(BRENDA SHTETEVE TË BASHKUARA) OSE EMAIL TEK
HELP@HUMANTRAFFICKINGHOTLINE.ORG



NJIHUNI ME TË DREJTAT TUAJA

Gjatë qëndrimit tuaj në Shtetet e Bashkuara ju keni të drejtë për:

- t'u paguar në mënyrë të drejtë
- të pasur një vend pune të sigurtë dhe të shëndetshëm
- të kërkuar ndihmë nga sindikatat, grupet e të drejtave të punës dhe të emigrantëve
- t'u larguar nga një situatë abuzive punësimi
- të mos qenë viktimë e ngacmimit seksual dhe shfrytëzimit seksual

Vizitoni faqen e web-it *MigrantWorker.gov* për më shumë informacion në lidhje me këto të drejta

NËSE JU JENI KEQTRAJTUAR, KONTAKTONI LINJËN E POSAÇME TË PANDËRPRERË TELEFONIKE TË QENDRËS KOMBËTARE TË TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE 1-888-373-7888 (BRENDA SHBA-SË), DËRGONI MESAZH ME TEKSTIN "HELP" TEK (233733) (BRENDA SHTETEVE TË BASHKUARA) OSE EMAIL HELP@HUMANTRAFFICKINGHOTLINE.ORG.

TELEFONATAT JANË ANONIME, KONFIDENCIALE DHE TË SIGURTA, PAVARËSISHT STATUSIT TË IMIGRACIONIT. SPECIALISTË TË TRAJNUAR JANË GJITHMONË NË DISPOZICION PËR NDIHMË NË MË SHUMË SE 200 GJUHË. MËSONI MË SHUMË NË: WWW.HUMANTRAFFICKINGHOTLINE.ORG

Nëse jeni në rrezik të menjëhershëm, telefononi policinë në numrin 911 (brenda SHBA). Tregojuni atyre natyrën e emergjencës, vendndodhjen tuaj dhe numrin e telefonit nga po merrni. Kërkoni një përkthyes nëse nuk flisni Anglisht.

Nëse keni aplikuar për një vizë jo-Emigruese si punonjës shtëpie A-3, G-5, H, J, NATO-7, TN, ose B-1 ju duhet të pajiseni me këtë pamflet

- Kur t'ju lëshohet viza (nëse nuk keni zhvilluar intervistë), ose
- Gjatë intervistës suaj për vizë. Oficeri i konsullatës duhet të verifikojë që ju e keni marrë, lexuar, si dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj broshurë përpara se të merrni një vizë.

Oficeri konsullor do t'ju japë juve broshurën dhe do ta diskutojë përmbajtjen e saj me ju. Gjithashtu, oficeri konsullor duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje që ju mund të keni rreth informacionit në broshurë.

Ju mund të merrni ndihmë nga konsullata juaj në Shtetet e Bashkuara përmes Programit të Partneritetit Konsullor (CPP) të Departamentit Amerikan të Punës. Përmes CPP-së, konsullata juaj mund t'ju ndihmojë, t'ju ndihmojë të gjeni burime dhe t'ju mbështesë në paraqitjen e një ankese nëse besoni se të drejtat tuaja janë shkelur. Për një listë të vendeve partnere, vizitoni:

www.dol.gov/general/migrantworker/support

U.S. DEPARTMENT of STATE

PAVARËSISHT STATUSIT TUAJ TË IMIGRIMIT, JU KENI TË DREJTA

Punëdhënësi juaj nuk mund t'ju pushojë nga puna, t'ju trajtojë keq, apo të refuzojë t'ju paguajë për ushtrimin e të drejtave tuaja.

JU KENI TË DREJTË TË:

1. Të paguheni në mënyrë të drejtë

- Punëdhënësi juaj duhet t'ju paguajë për të gjithë punën që bëni. Punëdhënësi juaj duhet t'ju paguajë të paktën pagën minimale ligjore federale për shumicën e punëve.
- Punëdhënësi juaj duhet t'ju paguajë më shumë se paga minimale federale nëse:
 - Ju punoni në një shtet, qytet, qark, ose zonë lokale që ka një pagë minimale më të lartë.
 - Nëse kërkohet nga kontrata juaj e punës ose programi i vizës.
 - **Nëse punoni më shumë se 40 orë në javë, punëdhënësi juaj mund të ketë detyrimin t'ju paguajë 1.5 herë më shumë se paga juaj e zakonshme për orët shtesë. Për shembull, nëse fitoni \$10 në orë, mund të merrni \$15 për çdo orë shtesë.**
- Nëse punëdhënësi juaj heq para nga paga juaj, kjo quhet zbritje. Deklarata juaj e të ardhurave (si p.sh. një "fletë pagese") duhet të tregojë çdo zbritje. Zbritjet mund të jenë për gjëra që ju zgjidhni vetë, si sigurimi shëndetësor ose kuotat e sindikatës, dhe mund të jenë të detyrueshme për disa taksa.
- Punëdhënësi juaj zakonisht nuk mund të heqë para nga paga juaj ose t'ju detyrojë të paguani për uniformat, pajisjet e sigurisë, mjetet e kërkuara, furnizimet, pajisjet, ose tarifat e rekrutimit. Për disa lloje vizash, strehimi duhet të ofrohet falas.
- Punëdhënësi juaj nuk mund të hakmerret, t'ju ngacmojë, t'ju frikësojë, ose të ndërmarrë veprime negative kundër jush nëse pyetni rreth pagës, orëve të punës dhe të drejtave të tjera, nëse paraqitni një ankesë, ose bashkëpunoni me një hetim mbi Pagën dhe Orët e Punës.
- Zbritjet për të paguar gjëra që ju zgjidhni vetë, si sigurimi shëndetësor ose kuotat e sindikatës, mund të zbriten nga paga juaj. Zbritjet për disa taksa mund të jenë gjithashtu të detyrueshme.

Nëse keni pyetje ose shqetësime rreth pagave dhe fletës suaj të pagës, telefononi në 1-866-487-9243 ose vizitoni një Zyrë Lokale për Paga dhe Orët e punës: www.dol.gov/agencies/whd/contact/local-offices.

1 Shikoni www.dol.gov/whd/minimumwage.htm për pagën minimale aktuale.



KËSHILLË: Në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit tuaj, mund të kërkohet të keni sigurim shëndetësor gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara. Ju gjithashtu mund të kualifikoheni për ndihmë financiare për të ulur koston e sigurimit shëndetësor.

2. Punoni në një Vend Pune të Shëndetshëm dhe të Sigurt

Vend Pune i Sigurt: Punëdhënësi juaj duhet ta mbajë vendin tuaj të punës të shëndetshëm dhe të sigurt.

Trajnimi: Punëdhënësi juaj duhet t'ju japë informacion dhe trajnim rreth rreziqeve të punës, si të shmangni lëndimet ose aksidentet, dhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit për vendin tuaj të punës. Trajnimi duhet të jetë në një gjuhë që ju e kuptoni.

Pajisjet e Sigurisë së Kërkuara: Ju keni të drejtë të merrni pajisjet e kërkuara të sigurisë, si doreza ose një rrip dhe litar për mbrojtje nga rënia nga lartësia, dhe punëdhënësi juaj duhet t'ju mësojë si t'i përdorni këto pajisje siç duhet.

Raportimi i Lëndimeve dhe Sëmundjeve të Lidhura me Punën: Ju keni të drejtë të raportoni një lëndim ose sëmundje dhe të shihni dhe të merrni kopje të dosjeve tuaja mjekësore nga punëdhënësi juaj.

Paraqitja e një Ankese për Siguri dhe Shëndet: Nëse mendoni se puna juaj është e pasigurt ose e rrezikshme për shëndetin tuaj, ju (ose dikush që ju përfaqëson) mund të paraqisni një ankesë konfidenciale në Administratën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (OSHA). Nëse mundeni, është mirë të merrni një punëtor tjetër si dëshmitar kur i tregoni punëdhënësit për kushtet e pasigurta dhe gjithashtu të ndani shqetësimet tuaja me mesazh ose email që të ketë një provë me shkrim. Ju mund të flisni privatisht dhe konfidencialisht me inspektorët e OSHA dhe të shihni rezultatet e inspektimeve ose testeve të kryera për të gjetur rreziqet në vendin e punës.

Mbrojtja nga Hakmarrja: Ju mund të flisni hapur për rreziqet në punë. Ju keni të drejtë të paraqisni një ankesë në OSHA nëse besoni se punëdhënësi juaj po ju ndëshkon për ngritjen e shqetësimeve rreth rreziqeve të sigurisë dhe shëndetit. Nëse besoni se po ndëshkoheni për ngritjen e shqetësimeve, paraqisni një ankesë brenda 30 ditëve nga ndëshkimi i pretenduar. Për më shumë informacion vizitoni: www.whistleblowers.gov.



KËSHILLË: Para se të niseni për në Shtetet e Bashkuara, merrni këshilla nga organizatat e punëtorëve ose ish-punëtorë migrantë. Ata mund t'ju japin emra dhe numra të personave ose organizatave që mund të kontaktoni nëse keni probleme ose pyetje gjatë qëndrimit tuaj në Shtetet e Bashkuara.

Për më shumë informacion mbi të Drejtat e Punëtorëve në OSHA, vizitoni:
www.osha.gov/workers

Trajtim Mjekësor: Ju mund të vizitoni një mjek ose infermier vetë nëse keni nevojë ta bëni këtë. Nëse lëndoheni ose sëmurëni nga puna, punëdhënësi juaj duhet të paguajë për kujdesin tuaj mjekësor dhe një pjesë të pagave tuaja të humbura. Kërkoni kopje të çdo dokumentacioni nga mjeku, klinika, ose spitali. Në shumicën e rasteve, ju mund të paraqisni kërkesë për kompensim të punëtorëve në shtetin ku punoni, që është një pagesë për lëndimet ose sëmundjet e lidhura me punën. Gjeni zyrën tuaj lokale për të kërkuar kompensim të punëtorëve këtu: ***www.dol.gov/agencies/owcp/wc***

Strehimi: Nëse punëdhënësi juaj ofron strehim, duhet të jetë i pastër dhe i sigurt. Ju keni të drejtë të lëvizni lirisht nga strehimi juaj.

Banjoja: Banjot duhet të jenë të pastra dhe të lehta për t'u arritur. Punëdhënësi juaj duhet t'ju lejojë të përdorni banjon sa herë që keni nevojë dhe të sigurojë stacione larjeje me ujë dhe sapun ose agjentë të ngjashëm pastrimi, në mënyrë që të mund të lani duart.

Ujë i Pijshëm: Ju keni të drejtë të merrni ujë të pijshëm pa pagesë.

Nxehtësia: Punëdhënësit që mbulohen nga OSHA duhet t'ju mbrojnë nga temperaturat ekstreme dhe duhet të kenë një program për të parandaluar sëmundjet nga nxehtësia. Nëse po punoni me ose pranë pesticideve ose kimikateve të rrezikshme, punëdhënësi juaj duhet të:

- Sigurohet që të keni sapun dhe ujë për të larë duart.
- Të sigurojë pajisjet e duhura të kërkuara për punën (si një respirator ose doreza) dhe t'ju mësojë si t'i përdorni siç duhet.



- T'ju ofrojë trajnim të paguar mbi kimikatat në vendin e punës, në mënyrë që të kuptoni rreziqet e kimikateve me të cilat po punoni.
- T'ju tregojë se ku dhe kur janë spërkatur pesticidet dhe kur është e sigurt të hyni përsëri në një zonë për të shmangur ekspozimin aksidental. Shmangni zonat ku po aplikohen pesticidet.

Nëse mendoni se puna juaj është e pasigurt dhe dëshironi një inspektim ose më shumë informacion rreth të drejtave tuaja, telefononi në 1-866-4-USA-DOL ose vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Punës (dol.gov ose migrantworker.gov).

Nëse jeni një punëtor H-2A dhe keni pyetje ose shqetësime rreth shëndetit dhe sigurisë në vendin tuaj të punës, strehimit, ose transportit, telefononi në 1-866-487-9243 ose vizitoni një Zyrë Lokale për Paga dhe Orë të Punës: www.dol.gov/agencies/whd/contact/local-offices.

3. Kërkoni Ndihmë nga Sindikatat, Grupet e të Drejtave të Imigrantëve dhe Punëtorëve

Në shumicën e rasteve, ju keni të drejtë të:

- Bashkoheni me kolegët tuaj për t'i kërkuar punëdhënësit paga më të mira ose kushte më të mira pune.
- Formoni, të bashkoheni dhe të mbështesni një sindikatë në punën tuaj. Për të mësuar më shumë rreth këtyre të drejtave, vizitoni: www.nlrb.gov
- Merrni pjesë në fjalime publike, tubime dhe demonstrata për paga më të mira ose kushte më të mira pune.

4. Largimi nga një Punë

- Ju nuk jeni të detyruar të qëndroni në punën tuaj nëse punëdhënësi juaj po ju trajton keq ose nëse nuk ndiheni të sigurt. **Ju mund të kontaktoni Linjën Kombëtare të Ndihmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në numrin 1-888-373-7888 për ndihmë.**
- Statusi juaj i imigracionit nuk do të jetë më i vlefshëm nëse largoheni nga punëdhënësi juaj, por mund të jeni në gjendje të ndryshoni statusin tuaj ose të punoni për një punëdhënë të ri që ju sponsorizon. Nëse punëdhënësi juaj po hetohet nga një agjenci pune, mund të keni mundësi të merrni mbrojtje të përkohshme nga dëbimi dhe një leje pune të përkohshme. Për më shumë detaje, vizitoni:

www.dhs.gov/enforcement-labor-and-employment-laws

Pavarësisht statusit tuaj të imigracionit, ju mund të kontaktoni Linjën Kombëtare të Ndihmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore nëse mendoni se jeni viktimë e trafikimit në 1-888-373-7888 për ndihmë ose Bordin Kombëtar të Marrëdhënieve të Punës në 1-844-762-6572 dhe të kërkonti të flisni me një Koordinator Rajonal të Imigracionit.

Për më shumë burime për punëtorët dhe për kontaktet në qeverinë e Shteteve të Bashkuara për shqetësime specifike, vizitoni: *MigrantWorker.gov/TrabajadorMigrante.gov*.

5. E drejta për të mos u diskriminuar dhe ngacmuar.

- Punëdhënësi juaj nuk mund t'ju trajtojë ndryshe ose keq për shkak të moshës suaj (nëse jeni 40 vjeç ose më i/e madh/e), gjinisë, racës, origjinës kombëtare dhe etnisë, ngjyrës, fesë, informacionit gjenetik (përfshirë historinë mjekësore familjare), ose aftësisë së kufizuar.
- **Për të paraqitur një ankesë për diskriminim, vizitoni: www.eeoc.gov/how-file-charge-employment-discrimination. Për të paraqitur një ankesë për diskriminim për shkak të statusit tuaj të shtetësisë, vizitoni: www.justice.gov/crt/filing-charge.**
- **Askush nuk mund t'ju ngacmojë verbalisht, fizikisht, ose seksualisht.**

6. E drejta juaj për të mos u shfrytëzuar në mënyrë te padrejtë.

- Askush nuk ka të drejtë t'ju shfrytëzojë seksualisht, duke përfshirë prekjet në mënyrë seksuale; ose duke ju detyruar, me anë të mashtrimit, apo kërcënimit për të kryer ndonjë akt seksual si puthje, marrëdhënie seksuale, seks oral, apo vojerizëm.
- Shikoni faqen 12 për më shumë informacion mbi shfrytëzimin në punë dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Nëse besoni se të drejtat tuaja janë shkelur, raportojeni në Linjën Kombëtare të Ndihmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në 1-888-373-7888 (brenda Shteteve të Bashkuara) ose në një nga faqet e internetit të listuara në faqet 15 dhe 16 të këtij pamfleti. Nëse nuk flisni anglisht, kërkonti një përkthyes.





KËSHILLË: Këshillat ligjore nga punëdhënësi, kontraktori, ose rekrutuesi juaj mund të jenë të njëanshme. Kërkoni këshilla nga një avokat i pavarur.

TË DREJTA SHITESË BAZUAR NË STATUSIN TUAJ JOIMIGRANT

Punonjës Shtëpiakë me Viza A-3, G-5, NATO-7 dhe B-1

Punëdhënësi juaj duhet t'ju japë një kontratë pune që përputhet me ligjet e Shteteve të Bashkuara, duke përfshirë kërkesat që kontrata:

- Të jetë në një gjuhë që ju e kuptoni.
- Të tregojë pagën tuaj për orë, e cila duhet të jetë më e larta ndërmjet pagës minimale federale, shtetërore, ose lokale të Shteteve të Bashkuara.
- Të tregojë se punëdhënësi do të sigurojë strehim dhe ushqim falas (nëse jetoni në rezidencën e punëdhënësit) dhe biletë avioni vajtje-ardhje.
- Të tregojë saktësisht kohën që punëdhënësi duhet t'ju japë përpara, në rast se do ju largojë nga puna dhe kohën që ju duhet t'i jepni punëdhënësit nëse planifikoni të largoheni.
- Të përfshijë çdo përfitim tjetër të kërkuar për punëtorët shtëpiakë në Shtetet e Bashkuara, si pushime të paguara, leje të papaguara për sëmundje dhe kompensim për punëtorët.

Sigurohuni që ta kuptoni kontratën dhe të merrni një kopje të saj. Mos nënshkruani një kontratë nëse nuk e kuptoni se çfarë thotë.

Kërkesa Shtesë për Punëtorët Shtëpiakë me Viza A-3, G-5 dhe NATO-7
Më së pakti, kontrata duhet të përfshijë:

- Një marrëveshje nga punëdhënësi juaj për të ndjekur të gjitha ligjet e Shteteve të Bashkuara.
- Informacion se sa shpesh do të paguheni, si do të paguheni, detyrat tuaja të punës, orët e punës javore, festat zyrtare, ditët e lejes për sëmundje dhe ditët e pushimeve.
- Një marrëveshje me punëdhënësin që të mos ju mbajë pasaportën tuaj, kontratën e punës, ose sende të tjera personale.



Vizat H-2A për Punëtorët Bujqësorë të Përkohshëm

- Ju nuk duhet të paguani kurrë tarifa për tu punësuar. Nëse dikush ju kërkon të paguani një tarifë, kontaktoni ambasadën ose konsullatën lokale të Shteteve të Bashkuara nëse jeni ende në vendin tuaj të origjinës, ose Divizionin e Pagave dhe Orëve në 1-866-487-9243 nëse jeni në Shtetet e Bashkuara.
- Punëdhënësi juaj ose kushdo që punon me punëdhënësin tuaj nuk mund t'ju detyrojë të hyni në borxh ose t'ju detyrojë të shlyeni një borxh. **Nëse ndodh kjo, telefononi Linjën Kombëtare të Ndihmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në 1-888-373-7888 nëse jeni në Shtetet e Bashkuara ose ambasadën ose konsullatën lokale të Shteteve të Bashkuara nëse jeni në vendin tuaj të origjinës.**

Punëdhënësi juaj duhet:

- T'ju paguajë, të paktën dy herë në muaj, për të gjithë punën që bëni me normën e specifikuar në urdhrin tuaj të punës ose kontratën e punës, dhe në kohët e përcaktuara sipas kontratës suaj të punës. Norma e pagesës mund të jetë më e lartë se paga minimale federale, shtetërore, ose lokale.
- Të sigurojë ose të paguajë për transportin nga vendi juaj i rekrutimit deri te vendi i punës dhe për ushqimet ditore gjatë këtij udhëtimi, ose t'ju rimbursojë për këto shpenzime pasi të keni përfunduar gjysmën e kohës që duhet të punoni sipas kontratës suaj të punës.
- T'ju rimbursojë për udhëtimin deri te vendi i punës dhe shpenzimet e vizës gjatë javës së parë të punës nëse paga juaj, pas zbritjes së shpenzimeve, është më pak se paga minimale në Shtetet e Bashkuara.

Nëse jeni një punëtor H-2A ose H-2B dhe keni pyetje ose shqetësime rreth të drejtave tuaja, telefononi në 1-866-487-9243 ose vizitoni një Zyrë Lokale për Paga dhe Orë: www.dol.gov/agencies/whd/contact/local-offices.

Për Punëtorët Bujqësorë të Përkohshëm H-2A

Punëdhënësi juaj duhet:

- T'ju japë një kontratë pune të shkruar në një gjuhë që ju e kuptoni. Ajo duhet të përfshijë detaje rreth pagës suaj, sa do të zgjasë puna, orët e punës, përfitimet (si transporti, strehimi dhe ushqimet ose pajisjet për gatim), dhe çdo zbritje nga paga juaj. Ju nuk duhet të keni zbritje nga paga juaj për Sigurimet Shoqërore dhe Medicare të Shteteve të Bashkuara ndërsa jeni duke punuar si punëtor H-2A.



- **Siguro strehim të sigurt dhe të pastër pa kosto për ty.**
- **Siguro transport falas nga strehimi që të japin deri në vendin e punës.**
- **Siguro transport të sigurt nga shoferë të licencuar me makina të sigurta dhe të pajisura me të gjitha pajisjet e nevojshme të sigurisë.**
- **Siguro 3 vakte në ditë, ose një vend për të gatuar që është falas dhe i lehtë për ty për t'u përdorur.**
- Mos të ndëshkosh ose pengosh që të takosh punonjës qeveritarë ose avokatë që të informojnë për të drejtat e tua dhe të ndihmojnë të paraqesësh ankesa.
- Siguro ose paguaj për transportin, strehimin dhe ushqimin, nga vendi i punës deri në shtëpinë tënde në vendin tënd pasi të përfundosh periudhën e kontratës së punës.
- Ofro punë për të paktën 3/4 e ditëve të punës në kontratën e punës ose paguaj për orët që nuk ofrohen.

Viza H-2B për Punonjësit Përkohëm Jo-Bujqësorë

Punëdhënësi yt duhet:

- Të të japë një urdhër pune me shkrim në një gjuhë që ti kupton. Ai duhet të përfshijë detaje rreth pagesës, sa do të zgjasë puna, orët e punës, çdo përfitim që punëdhënësi jep vullnetarisht (si transport, strehim, vakte ose ambiente gatimi) dhe çdo zbritje nga paga.
- Të paguajë për transportin, strehimin dhe ushqimin nga vendi i punës deri në shtëpinë tënde nëse përfundon periudhën e kontratës së punës ose nëse punëdhënësi të lejon të largohesh para përfundimit të periudhës.

Viza J-1 Shkëmbim Vizitorësh

- Formulari yt i nënshkruar DS-2019 shpjegon datat e programit, kategorinë e programit, emrin e sponsorit dhe vendin ku do të zhvillohet programi i shkëmbimit. Sponsorin yt duhet të përditësojë Formularin DS-2019 gjatë programit tënd për të reflektuar çdo ndryshim në financim, vendin e aktivitetit dhe datat e programit.



KËSHILLË: Punëdhënësi yt duhet të të paguajë në kohë. Në Shtetet e Bashkuara është praktikë e zakonshme që punonjësit të paguheshin një herë në çdo dy javë, megjithatë orari i pagesës mund të ndryshojë sipas kontratës së punës.

- Sponsori yt duhet të shpjegojë të gjitha kostot, kushtet dhe rregullat e programit të shkëmbimit, duke përfshirë një deklaratë me shkrim për punën që je dakord të bësh, sa do të paguhesh dhe sa orë duhet të presësh të punosh, nëse është e aplikueshme. **Nëse ke shqetësime urgjente për shëndetin, sigurinë ose mirëqenien, të lutemi kontakto Linjën e Emergjencës për Vizën J në numrin: 1-866-283-9090. Për pyetje ose çështje të përgjithshme, dërgo email në: jvisas@state.gov.**
- Sponsori yt duhet të sigurohet që ke mbulim për sigurimin mjekësor, riatdhesim dhe evakuim, por nuk është i detyruar t'i sigurojë ose paguajë ato.

Punë Verore dhe Udhetime

Sponsori yt duhet të ndihmojë në gjetjen e një pune pas një jave kërkimi në Shtetet e Bashkuara, nëse je nga një vend që përjashtohet nga viza dhe ke mbërritur pa punë. Sponsorët gjithashtu duhet të ofrojnë ndihmë të arsyeshme për të gjithë pjesëmarrësit në programin e Punës Verore me Udhëtim që dëshirojnë të ndryshojnë punë gjatë programit të tyre. Sponsorët duhet të vlerësojnë dhe të konfirmojnë vendet fillestare dhe çdo vend pune shtesë për të gjithë pjesëmarrësit e programit përpara se ata të fillojnë punën, sipas rregullave të programit.

Intern ose Trajner

Sponsori yt duhet të të japë një Plan Trajnimi/Internshipi (Formulari DS-7002) që përfshin një deklaratë me shkrim të çdo të ardhure që do të marrësh dhe një përmbledhje të qëllimeve të trajnimit të programit. Ti duhet të punosh të paktën 32 orë në javë.

Sponsori yt duhet të të japë një deklaratë me shkrim të kostove dhe tarifave që do të duhet të paguash dhe një vlerësim të shpenzimeve të jetesës në Shtetet e Bashkuara.

Sponsori yt duhet të sigurohet që ke mbulim sigurimi mjekësor, evakuimi dhe riatdhesimi, por nuk është i detyruar t'i sigurojë ose paguajë ato.



Au Pair:

Familja pritëse duhet të të ndihmojë të regjistrohesh dhe të ndjekësh kurse në një institucion pasuniversitar dhe të paguajë deri në 500 dollarë për këto kurse. Nëse je një au pair EduCare, familja pritëse duhet të paguajë deri në 1,000 dollarë për këto kurse.

Nuk ke detyrë të punosh më shumë se 10 orë në ditë ose 45 orë në javë. Nëse je një au pair EduCare, nuk ke detyrë të punosh më shumë se 10 orë në ditë ose 30 orë në javë.

Këshilltari yt lokal duhet të kontaktojë çdo muaj dhe të kontrollojë rregullisht situatën me familjen pritëse.

VIZA JUAJ JO-EMIGRUESE

Një vizë jo-emigruese është një dokument i qeverisë së SHBA-së që lejon njerëzit të vijnë në Shtetet e Bashkuara për arsye të caktuara, si për të punuar, për të studiuar, ose për të marrë pjesë në një program shkëmbimi kulturor. **Ju duhet të aplikoni për një vizë në një ambasadë ose konsullatë amerikane jashtë vendit** (Shënim: qytetarët kanadezë aplikojnë për pranimin në statusin J-1 në pikën e hyrjes). Pasi të merrni vizën, mund të udhëtoni në Shtetet e Bashkuara dhe ta tregoni atë për një zyrtar imigracioni amerikan ("oficer CBP") për të hyrë. Nëse viza juaj skadon, duhet të merrni një vizë të re para se të ktheheni në Shtetet e Bashkuara. Për më shumë detaje rreth procesit të aplikimit për vizë dhe vizës tuaj amerikane, vizitoni: ***usvisas.state.gov***.

Kur një oficer CBP ju lejon të hyni në Shtetet e Bashkuara, do të krijohet elektronikisht një Formular **I-94** (ndonjëherë mund të jetë një dokument në letër). Formulari **I-94** do të tregojë datën tuaj të hyrjes, llojin e vizës dhe datën deri kur duhet të largoheni nga Shtetet e Bashkuara. Ju duhet të largoheni nga Shtetet e Bashkuara përpara datës "admit until" për të qëndruar ligjërisht, përveç nëse bëni kërkesë për zgjatje të qëndrimit pranë Shërbimit të Shtetësisë dhe Imigracionit të SHBA-së (USCIS). **Ju mund të kontrolloni regjistrimin tuaj I-94 në: *https://i94.cbp.dhs.gov***.

- Kërcënimi për të të lënduar, deportuar, apo arrestuar ty apo familjen tënde nëse guxon të flasësh kundër padrejtësisë;
- Dëmtimi i atyre që kanë pasur guximin të largohen, të ankohen, apo të kërkojnë ndihmë;
- Kërcënimi për të të futur në listë të zezë, duke të penguar të punosh në Shtetet e Bashkuara përsëri.

Detyrimi për të bërë diçka për të shlyer një borxh

Një person nuk mund t'ju detyrojë të kryeni ose të vazhdoni të kryeni punë, shërbime ose veprime seksuale me pagesë për të shlyer një borxh, dhe nuk mund t'ju ndalojë të largoheni. Një person nuk mund ta ndryshojë papritur borxhin tuaj për ta bërë më të vështirë shlyerjen e tij, ose t'ju bëjë të mendoni se duhet të vazhdoni të punoni derisa të shlyhet borxhi. Shembuj përfshijnë:

- Të thuhet se i detyroheni një shumë shumë të madhe që është e vështirë të shlyhet në një kohë të arsyeshme;
- Të pretendohet se i detyroheni më shumë sesa keni rënë dakord, ose për gjëra për të cilat nuk keni rënë dakord më parë;
- Shtimi i tarifave për transport, strehim, ushqim dhe shpenzime të tjera që nuk janë përmendur më parë;
- Shtimi i tarifave, gjobave ose dënimeve për thyerjen e rregullave, për mosfitimin e mjaftueshëm, ose për moskryerjen e mjaftueshme të punës, shërbimeve ose veprimeve seksuale me pagesë.

KËSHILLË: Mbani një regjistër të detajuar të çdo komenti dhe/ose veprimi të papërshtatshëm që punëdhënësi juaj bën ndaj jush dhe shënoni emrat dhe numrat e telefonit të çdo dëshmitari.

Të mos jesh në gjendje të largohesh, të flasësh ose të kërkojë ndihmë Njerëzit nuk mund t'ju ndalojnë ju ose të tjerët të largoheni, të flisni apo të kërkonin ndihmë. Shembuj përfshijnë pretendimin se nuk mund të largohesh nga vendi i punës ose kufizimin e vendit ku mund të shkosh kur nuk je duke punuar.

- Gjithmonë duhet të kesh akses në pasaportën, vizën, certifikatën e lindjes apo dokumente të tjera identifikimi. Askush nuk duhet t'ia marrë këto dokumente.
- Duhet të kesh ushqim, pushim, gjumë apo ndihmë mjekësore të mjaftueshme kur të nevojitet. Askush nuk duhet t'i kufizojë këto gjëra.
- Duhet të jesh në gjendje të flasësh me familjen, me njerëz të tjerë në punë, me klientë apo me këdo tjetër që të duhet, si punonjës ligjorë ose shërbimesh sociale. Askush nuk duhet të të ndalojë të komunikosh lirshëm apo të kontrollojë atë që thua.

Të jesh i mashtruar

Askush nuk ka të drejtë të të mashtrojë apo të të detyrojë të punosh apo të kryesh akte seksuale komerciale kundër vullnetit tënd.

Shembuj të mashtrimeve dhe manipulimeve përfshijnë:

- Premtime të rreme për llojin e punës, orët e punës, kushtet e punës, kushtet e jetesës, apo pagesën;
- Të detyrojnë të punosh shumë më gjatë, në kushte më të këqija, apo për më pak pagesë sesa të është premtuar;
- Të thonë se nuk ke të drejtë;
- Të thonë se nuk do të besohet apo se do të deportohesh nëse përpiqesh të largohesh apo të kërkosh ndihmë;
- Të detyrojnë të gënjejsh për punëdhënësin apo punëtorët e tjerë.
- Premtimet e rreme mund të përfshijnë, për shembull, të thonë se do të kesh një punë si infermiere e kualifikuar, por më pas të detyrojnë të pastrosh një shtëpi pleqsh; ose të thonë se do të jesh dado, por më pas të detyrojnë të bësh vallëzim ekzotik apo akte seksuale komerciale.

A mund të të deportojë punëdhënësi nëse raporton abuzimin?

Ka programe që mbrojnë njerëzit që raportojnë abuzim apo keqtrajtim.

Këto programe mund të të lejojnë të qëndrosh në Shtetet e Bashkuara edhe nëse largohesh nga punëdhënësi yt. Nuk duhet të kesh frikë të kërkosh ndihmë, edhe nëse ke shqetësime për statusin tënd të imigracionit. **Telefononi Linjën Kombëtare të Ndhmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore në 1-888-373-7888 për të kuptuar opsionet tuaja.** Linja Kombëtare e Ndhmës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore nuk operohet nga Qeveria apo forcat e rendit.



KËSHILLË: Pasi të mbërrini në Shtetet e Bashkuara, mbajeni pasaportën dhe dokumentet e tjera të udhëtimit në një vend të sigurt ku mund t'i keni gjithmonë në dispozicion. Është e paligjshme që punëdhënësi juaj të marrë pasaportën tuaj.

PËR MË SHUMË INFORMACION RRETH:

- Procesit të aplikimit për vizë dhe për vizën amerikane: **usvisas.state.gov**.
- Trafikimit të qenieve njerëzore: **www.state.gov/j/tip**.
- Programit të Vizitorëve të Shkëmbimit me vizë J-1: **j1visa.state.gov**.
- Të drejtave tuaja për barazi dhe mbrojtjes nga diskriminimi në vendin e punës për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë (përfshirë shtatzëninë), origjinës kombëtare, moshës (40 vjeç e lart), aftësisë së kufizuar ose informacionit gjenetik, si dhe si të ngrini një padi për diskriminim: **www.eeoc.gov**.
- Sigurisë në vendin e punës, ose nëse mendoni se puna juaj është e pasigurt dhe dëshironi të kërkonin një inspektim: **www.osha.gov**.
- Si të zbuloni nëse pagat e papaguara janë mbledhur nga punëdhënësi juaj në emrin tuaj: **webapps.dol.gov/wow**.
- Të drejtave tuaja për të marrë pagesë të drejtë: **www.dol.gov/WHd/immigration**.
- Si të ngrini një ankesë për pagë: **<https://www.dol.gov/agencies/whd/contact/complaints>**.
- Të drejtës tuaj për të mos u diskriminuar për shkak të statusit tuaj të shtetësisë dhe për të ngritur një ankesë për diskriminim: **www.justice.gov/crt/filing-charge**.
- Të drejtës tuaj për t'u bashkuar me punëtorë të tjerë për të përmirësuar pagën ose kushtet e punës, përfshirë si të ngrini një padi: **www.nlrb.gov**.
- Të drejtave, detyrimeve dhe përjashtimeve tuaja për sigurimin shëndetësor: **[localhelp.healthcare.gov](https://www.localhelp.healthcare.gov)** (anglisht) dhe **[ayudalocal.cuidadodesalud.gov](https://www.ayudalocal.cuidadodesalud.gov)** (spanjisht).
- Të drejtave tuaja nëse jeni viktimë e një krimi. Akti për të Drejtat e Viktimave të Krimit: **<https://www.justice.gov/criminal/criminal-vns/victim-rights-derechos-de-las-v-ctimas>**.
- I-94: **<https://i94.cbp.dhs.gov/I94>**.
- Statusit të petitionit të punëdhënësit të ardhshëm, statusit të rastit USCIS online: **<https://egov.uscis.gov>**.
- Burimeve të USCIS për trafikimin e qenieve njerëzore:
 - **<https://www.dhs.gov/blue-campaign/resources-available-victims>**
 - **<https://www.uscis.gov/humanitarian/victims-of-human-trafficking-and-other-crimes>**.

- Programet e USCIS që ofrojnë përfitime imigrimi për punëtorët, si statusi joemigrues T dhe U:
<https://www.uscis.gov/humanitarian/victims-of-human-trafficking-and-other-crimes>
- Përfitimet për refugjatët dhe shërbimet e menaxhimit të rasteve nëse ka shqetësime për trafikimin, vizitoni Zyrën për Trafikimin e Personave (OTIP) në:
 - **<https://www.acf.hhs.gov/otip/victim-assistance/child-eligibility-letters>**
 - **<https://www.acf.hhs.gov/otip/victim-assistance/certification>**

Pyetjet më të zakonshme për punëtorët migrantë (të disponueshme në 8 gjuhë, duke përfshirë gjuhët Angleze, Spanjolle, Arabe, Kineze, Haitiane Kreole, Portugeze, Vietnameze dhe Tagalog), vizitoni:

MigrantWorker.gov ose
TrabajadorMigrante.gov



KËSHILLË: Është ide e mirë që të mbani shënime me shkrim gjatë të gjithë kohës për punën tuaj. Mbani një bllok dhe shënoni të gjitha ditët dhe orët që keni punuar, sa jeni paguar, datat që keni marrë pagesën, çdo zbritje që ju është bërë nga roga dhe arsyen përse.

MODEL DITARI JAVOR I PUNËS


Punëdhënësi:		Mbikëqyrësi:	
Data:	Veprimtaria:	Orët:	Pagesa:
		Filluar: _____ Mbaruar: _____ Total: _____	

Punëdhënësi:		Mbikëqyrësi:	
Data:	Veprimtaria	Orët:	Pagesa:
		Filluar: _____ Mbaruar: _____ Total: _____	

Punëdhënësi:		Mbikëqyrësi:	
Data:	Veprimtaria	Orët:	Pagesa:
		Filluar: _____ Mbaruar: _____ Total: _____	



THE UNITED STATES *of* AMERICA



Për të parë një version online të kësaj broshure dhe videon shoqëruese, përdorni kamerën e telefonit tuaj për të skanuar këtë QR kod dhe hapni linkun që shfaqet:



U.S. DEPARTMENT *of* STATE

Kjo broshurë u krijua në përputhje me Seksionin 202 të Aktit të Riautorizimit të Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit William Wilberforce të vitit 2008, Ligji Publik 110-457.